



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Në bazë të nenit 21, alineja E të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (në tekstin e mëtejme "FBK"), Bordi i FBK-së në mbledhjen e mbajtur më 28.07.2022 miraton këtë:

RREGULLORE PËR KOMISIONET E Federatës së Basketbollit të Kosovës

NENI 1 DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Me synimin për promovimin dhe zhvillimin e basketbollit, Federata e Basketbollit të Kosovës mund të formojë Komisione, të cilat do të shërbejnë për të zhvilluar sportin e basketbollit nëpërmjet përfshirjes së pjesëtarëve të ndryshëm të komunitetit të basketbollit e më gjerë.

Me Rregulloren e Komisioneve Këshillëdhënëse të Federatës së Basketbollit të Kosovës përcaktohen organizimi dhe aktiviteti i tyre, të cilat Komisione do të kontribuojnë në zhvillimin e lojës së basketbollit në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria", Blloku
C3 (Faza 2), Rr. Radovan
Zogoviq, Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë

NENI 2 KOMISIONET

2.1 Komisionet Këshillëdhënëse e të përhershme të FBK-së themelohen nga Bordi Ekzekutiv i FBK-së, dhe janë si më poshtë:

- Komisioni Mbikëqyrës për Planin Strategjik
- Komisioni Teknik
- Komisioni për Financa
- Komisioni për Basketbollin e Vajzave dhe Grave
- Komisioni i të Rinjve
- Komisioni i Veteranëve
- Komisioni për Licencim dhe Transfere
- Komisioni Disiplinor/Rregullore të Posaçme
- Komisioni Arbitrar/Rregullore të Posaçme
- Komisioni i Garave/Rregullore të Posaçme

2.2 Përveç Komisioneve të përhershme, Sekretari i Përgjithshëm i FBK-së mund të propozojë krijimin e Komisioneve të tjera Bordit Ekzekutiv të FBK-së dhe është ky i fundit që vendos nëse duhet formuar Komisione të tjera, të cilat do të shërbejnë në zhvillimin dhe avancimin e basketbollit në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

2.3 Përbërja e Komisioneve duhet të rishikohet çdo vit.





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria", Blloku
C3 (Faza 2), Rr. Radovan
Zogoviq, Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË
DHE SPORTIT



2.3 Përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë Rregullore, ose përcaktohet nga Bordi Ekzekutiv i FBK-së, secili Komision përbëhet nga një (1) Kryetar dhe të paktën katër (4) anëtarë të tjerë. Të dy gjinitë duhet të përfaqësohen në secilin Komision.

Sekretari i Përgjithshëm duhet të paraqesë një listë të kandidatëve tek Bordi Ekzekutiv i FBK-së, dhe është Bordi ai i cili e bën emërimin e anëtarëve të Komisioneve. Gjatë paraqitjes së listës, Sekretari i Përgjithshëm duhet të marrë në konsideratë personat nga komuniteti i basketbollit, të cilët kanë kontribuar, apo edhe vazhdojnë të kontribuojnë në mënyra të ndryshme për zhvillimin e sportit të basketbollit.

2.4 Anëtarët e Bordit të FBK-së mund të emërohen në secilin Komision si kryesues (Kryetar) të Komisioneve.

2.5 Nëse Kryetari i një Komisioni është përkohësisht i paaftë të përmbushë detyrat e tij, atëherë Bordi Ekzekutiv FBK-së me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm e emëron një zëvendës për të gjatë takimeve të Komisionit. Në rast se Kryetari nuk është në gjendje të përmbushë detyrat e tij për një afat më të gjatë, zëvendësuesi i tij në Komision e zëvendëson atë për pjesën e mbetur të mandatit të tij.

2.6 Sekretari i Përgjithshëm është anëtar zyrtar (ex officio) i të gjitha Komisioneve, pa të drejtë vote.

2.7 Anëtarët e Komisioneve kontribuojnë në punën e Komisioneve bazuar në njohuritë, aftësitë dhe ekspertizën e tyre, në funksion të zhvillimit të basketbollit në Kosovë. Puna e tyre në kuadër të Komisionit duhet të jetë e përgjegjshme dhe e pavarur nga çfarëdo ndikimi, nga brenda apo jashtë FBK-së.

2.8 Komisionet mblidhen kurdoherë që është e nevojshme me ftesë të Kryetarit të tyre, në konsultim me Sekretarin e Përgjithshëm.

2.9 Për t'u konsideruar që ka kuorum për mbledhjet e Komisionit duhet të jenë të pranishëm të paktën dy anëtarë.

2.10 Me miratimin e Sekretarit të Përgjithshëm, Komisionet mund të angazhojnë ekspertë dhe të caktojnë nën-komisionet për detyra specifike.

2.11 Një kopje e rendit të ditës dhe dokumenteve të punës do të dërgohet anëtarëve të Komisionit nga Sekretari i Përgjithshëm të paktën tre ditë para mbajtjes së mbledhjes.

2.12 Komisionet veprojnë vetëm në një kapacitet konsultativ dhe nuk ushtrojnë autoritet ekzekutiv. Sidoqoftë, Kryetarët dhe anëtarët e Komisioneve mund të thirren nga Sekretari i Përgjithshëm për të ushtruar detyra ekzekutive. Në raste të tilla, ata nuk do të veprojnë si përfaqësues të Komisioneve të tyre, por si të deleguar të Sekretarit të Përgjithshëm.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

2.13 Sekretari i Përgjithshëm mund të caktojë, mbi baza ad hoc, komitete të përbëra nga persona me aftësi të specializuara në fushën e tyre të ekspertizës për ta këshilluar atë. Sekretari i Përgjithshëm do të informojë Bordin Ekzekutiv të FBK-së për emërimin e komiteteve të tilla.

NENI 3

KOMISIONI MBIKËQYRËS PËR PLANIN STRATEGJIK

Komisioni Mbikëqyrës për Planin Strategjik të FBK-së është organi përgjegjës për mbikëqyrjen e implementimit të planit të miratuar nga Kuvendi i FBK-së.

Ky Komision ka për detyrë të mbajë mbledhje në baza tre mujore, duke kërkuar përgjegjësi për implementimin e Planit Strategjik nga Sekretari i Përgjithshëm i FBK-së, i cili e përfaqëson Zyrën Ekzekutive të FBK-së.

Komisioni Mbikëqyrës për Planin Strategjik të FBK-së udhëhiqet nga Kryetari i FBK-së.

NENI 4

KOMISIONI TEKNIK

Komisioni Teknik është organi kompetent për të gjitha çështjet në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e Rregullave Zyrtare të Basketbollit dhe gjendjen e basketbollit në Kosovë.

Në veçanti, ai ka këto detyra:

- Të monitorojë gjendjen e basketbollit në të gjithë territorin e Kosovës dhe t'i propozojë Bordit Ekzekutiv të FBK-së çdo masë që konsiderohet e dobishme për të përmirësuar nivelin teknik të pjesëmarrësve të saj dhe zhvillimin e sportit.
- Të jetë përgjegjës për trajnimin, ekzaminimin dhe kualifikimin e të gjithë gjyqtarëve, mbikëqyrësve, instruktorëve dhe komisionerëve (vendor/ndërkombëtarë) të FBK-së, si dhe për përgatitjen e tyre për garat ndërkombëtare për basketboll për të dy konkurrencat.

NENI 5

KOMISIONI PËR FINANCA

Komisioni për Financa i ka detyrat si më poshtë:

- Të rishikojë dhe rekomandojë projektbuxhetin e FBK-së për paraqitje në Bordin Ekzekutiv të FBK-së për miratim;
- Të përgatisë pasqyrat financiare për aprovim të Bordit Ekzekutiv;
- Të studiojë dhe rekomandojë pranimin e raportit të auditorit tek Bordi Ekzekutiv; dhe
- Të rekomandojë politikat e investimeve financiare.

Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria", Blloku
C3 (Faza 2), Rr. Radovan
Zogoviç, Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë



RUGOVË GROWZILLAS



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

NENI 6

KOMISIONI PËR BASKETBOLLIN E VAJZAVE DHE GRAVE

Komisioni për Basketbollin e Vajzave dhe Grave i ka detyrat si më poshtë:

- Të monitorojë gjendjen e basketbollit në konkurrencën e femrave në të gjithë territorin e Kosovës dhe t'i propozojë Bordit Ekzekutiv të FBK-së çdo masë që konsiderohet e dobishme për të përmirësuar nivelin e basketbollit tek femrat.
- Ti japin rekomandime Komisionit të Garave në FBK në lidhje me sistemin e garave në konkurrencën e femrave.
- Ti japin rekomandime Drejtorit Teknik në FBK në lidhje me implementimin e projekteve të vajzave.
- Ti japin rekomandime Drejtorit të Përfaqësuesve në FBK në lidhje me zhvillimin e programeve të ekipeve nacionale të Kosovës në konkurrencën e femrave.
- Ti japin rekomandime Menaxherit të Basketbollit 3x3 në FBK në lidhje me zhvillimin e programeve të basketbollit 3x3 në të gjithë territorin e Kosovës në konkurrencën e femrave.

NENI 7

KOMISIONI I TË RINJVE

Komisioni i të Rinjve i ka detyrat si më poshtë:

- Të monitorojë gjendjen e basketbollit tek gjeneratat e reja (vajza/djem) përreth Kosovës dhe t'i propozojë Bordit Ekzekutiv çdo masë që konsiderohet e dobishme për të përmirësuar nivelin e basketbollit tek të rinjtë.
- Ti japin rekomandime Komisionit të Garave në FBK në lidhje me sistemin e garave të kategorive të reja.
- Ti japin rekomandime Drejtorit Teknik në FBK në lidhje me implementimin e projekteve të të rinjve, duke përfshirë edhe MiniBasketbollin.
- Ti japin rekomandime Drejtorit të Përfaqësuesve në FBK në lidhje me zhvillimin e programeve të ekipeve nacionale të Kosovës të gjeneratave të reja.
- Ti japin rekomandime Koordinatorit dhe Menaxherit të Basketbollit 3x3 në FBK në lidhje me zhvillimin e programeve të basketbollit 3x3 në të gjithë territorin e Kosovës tek kategoritë e reja.

NENI 8

KOMISIONI I VETERANËVE

Komisioni i Veteranëve i ka detyrat si më poshtë:

- Është organi kompetent për organizimin e garave të veteranëve në kuadër të FBK-së në të dyja konkurrencat.
- Ti jap rekomandime Komisionit të Garave të FBK-së në lidhje me sistemin e garave të kategorisë së veteranëve.
- Të ngritë nivelin organizativ të veteranëve nëpër klubet e basketbollit.
- Të masivizojë lëvizjen e basketbollit për veteran në Kosovë.
- Të bashkëpunojë me veteranët e Federatave të tjera Nacionale.
- Të organizojë aktivitetet e tjera që shërbejnë për zhvillim dhe organizim të veteranëve në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Federata e Basketbollit të Kosovës

+383 48 703 333
federata@basketbolli.com

Lagja "Arbëria", Blloku
C3 (Faza 2), Rr. Radovan
Zogoviq, Hyrja 7
10000 Prishtinë, Kosovë





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

NENI 9

KOMISIONI PËR LICENCIM DHE TRANSFERE

Komisioni për Licencim dhe Transferë i ka detyrat si më poshtë:

- Para çdo fillim edicioni të shqyrtojë dhe rekomandojë për aprovim aplikacionet për licencim të klubeve, shkollave e akademive të basketbollit.
- Para çdo fillim edicioni të shqyrtojë dhe rekomandojë aplikacionet për licencim të lojtarëve/eve.

NENI 10

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Sipas nevojës, me propozim të Komisionit përkatës dhe me aprovim të Bordit Ekzekutiv të FBK-së, mund të zhvillohen Rregullore të veçanta për punën e Komisionit.

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohen të gjitha dispozitat tjera në dokumentet tjera që rregullojnë çështje që rregullohen me këtë rregullore.

NENI 11

HYRJA NË FUQI

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj nga Bordi Ekzekutiv i Federatës së Basketbollit të Kosovës.

Miratuar në Prishtinë, më 28.07.2022.

Në emër të Bordit Ekzekutiv të FBK-së,

Arben FETAHU

Kryetar

Federata e Basketbollit të Kosovës

